

ALBANA MEMA**QEVERIA E FAN NOLIT NË OPTIKËN E DIPLOMACISË
BRITANIKE**

Zhvillimet politike të qershorit të vitit 1924 i dhanë goditje të rëndë jetës parlamentare, pluralizmit dhe demokracisë në Shqipëri. Ngjarjet e qershorit 1924 ishin një kryengritje antiqeveritare, në të cilën mori pjesë ushtria dhe grupe të ndryshme të opozitës. Roli i ushtrisë ishte parësor dhe do të ishte jo e saktë që t'iu jepej përparësi rolit të forcave civile të rekrutuara prej disa krerëve të opozitës. Qershori i vitit 1924 përmbysi përfundimisht sistemin politik të krijuar nga Kongresi i Lushnjës dhe i hapi rrugën zhvillimeve kaotike në politikën shqiptare.

Në fushën e qeverisjes, Shqipëria me Nolin bëri një hap mjaft të madh prapa, i cili do të kishte pasoja negative në të gjitha institucionet e tjera. Marrja e postit të kryeministrit nga Noli ishte në kundërshtim të plotë me Statutin e Lushnjës dhe për pasojë, tërësisht e paligjshme. Në këtë kohë, krahas parlamentit, ishte shpërndarë edhe Këshilli i Lartë, i cili kishte qenë një organ funksional dhe i pranuar, para ngjarjeve të qershorit. Kështu, ishte krijuar një vakuum i rrezikshëm institucional, si rezultat i shkatërrimit të dy shtyllave kryesore të shtetit: Parlamentit dhe Regjencës. Kjo ishte e mjaftueshme për ta cilësuar qeverinë e Nolit, si një qeveri të paligjshme dhe ardhjen e tij në pushtet, si një grusht shteti. Mungesa e kohezionit programor dhe politik është një argument i fortë që kryengritja e qershorit, mund të konsiderohet më tepër si grusht shteti, se sa si një revolucion.

Përveç qeverive që vepruan mbi baza kushtetuese, dhe atyre jokushtetuese, të Qazim Koculit, Hasan Prishtinës dhe Idhomene Kosturit, gjatë periudhës 1920-1924, veprimi edhe qeveria e Nolit.

Ky klasifikim është bërë në përputhje me legjitimitetin e tyre, i cili përcaktohet në bazë të teorive mbi të drejtën kushtetuese. Në këtë këndvështrim, një qeveri quhet jokushtetuese, kur ajo nuk është e mandatuar nga vullneti i lirë i popullit, i cili është deleguar në Asamblatë e ndryshme përfaqësuese të këtij të fundit.

Qeveria jokushtetuese e Nolit, mbetet unike në historinë shqiptare të viteve 1920-1925, sepse ajo ishte e vetmja, e cila nuk u dekretua nga

kryetari i shtetit dhe nuk u votua as formalisht në Parlament. Anëtari i vetëm i mbetur në Këshillin e Lartë, Sotir Peci, refuzoi dekretimin, duke kërkuar mbledhjen e parlamentit ose kalimin në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

Vetëm një qeveri e shkathët, solide dhe me vullnet të fortë mund ta kapërcente situatën dhe ta shpëtonte vendin nga anarkia, duke i rikrijuar institucionet. Por, qeveria “revolucionare” nuk i pati këto kapacitete. Ajo ishte më e përçara dhe përveç legjitimitetit, asaj i mungonte kohezioni e për pasojë edhe energjia qeverisëse. Kjo ishte një provë tjetër, e mungesës së respektit për institucionet qeverisëse të vendit dhe ky, nuk ishte një rast i izoluar apo i veçantë i qëndrimit të fituesve të qershorit ndaj institucioneve.

Ardhja në pushtet me dhunë, krijimi i Gjykatës politike, shpërndarja e Asamblesë Kushtetuese, refuzimi për të zhvilluar zgjedhje të lira etj., ishin prova të karakterit autoritar të qeverisë së Nolit. Gjithashtu, anarkia që pasoi krijimin e saj, dëshmoi se kjo qeveri ishte një institucion i paorganizuar, që nuk vepronte në bazë të rregullave ligjore. Stili diktatorial i Nolit, nuk e ndihmoi që të fitonte aleatë brenda dhe jashtë vendit apo të siguronte ndihmën e huaj financiare. Pothuajse gjatë gjithë kohës së ekzistencës së saj, qeveria e Nolit mbeti e ekspozuar nga rreziku i përmbysjes nga brenda. Pra, me shkatërrimin e Asamblesë Kushtetuese, Këshillit të Naltë dhe të qeverisë legjitime, ishte shkatërruar i tërë sistemi, i cili tashmë po krijonte rreziqe të mëdha.

Të gjitha këto tipare të qeverisë së Nolit dhe një sërë konsideratash të tjera, ishin në fokusin e vëzhgimeve dhe analizave të diplomatëve britanikë në Shqipëri dhe të qeverisë britanike të cilët, përcaktuan qëndrimin e tyre ndaj ngjarjeve të vitit 1924 dhe qeverisë së Nolit.

Menjëherë pas formimit të qeverisë, Fan Noli i dërgoi një telegram Kryeministrit dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme të Britanisë së Madhe, MacDonald, me të cilin lajmëronte se ishte autorizuar nga ana e Këshillit të Lartë të Regjencës të formonte qeverinë liberale. Një telegram me përmbajtje të njëjtë, Fan Noli u dërgoi edhe qeverive të shteteve të tjera. Shumica e qeverive iu përgjigjën telegramit me një ton kortezie, por pa njohjen *de jure*. Vetëm qeveria greke u përgjigj menjëherë dhe e njohu *de jure* qeverinë e Fan Nolit. Qeveria britanike, nuk denjoi as që t'i përgjigjej telegramit të Fan Nolit.

Çështja e njohjes së qeverisë së Fan Nolit nga Britania e Madhe

Politika e mosnjohjes, që u bë guri i themelit të politikës së Fuqive të Mëdha, ishte më shumë rezultat i veprimeve të Nolit, se sa vendosmëri e botës së jashtme për të shtypur lëvizjen e tij që kishte afishuar një program progresiv. Duke përlligjur qeverinë, Noli mund të kishte krijuar një premisë themelore për njohjen ndërkombëtare. Fuqitë e huaja e shihnin qeverinë e Nolit si shfaqjen e një qeverie tjetër të paqëndrueshme, e bazuar mbi grupe politike që kishin lëkundur themelet e stabilitetit dhe që kishin uzurpuar pushtetin ilegalisht. Refuzimi i njohjes ishte produkt i një sërë faktorëve të cilët po i shtjellojmë më poshtë.

Që më 18 qershor, Foreign Office informoi konsullin e parë në legatën britanike, Robert Parr, për faktin se qeveria e Nolit nuk duhej njohur. Në telegramin përkatës thuhej: “Sjellja juaj u aprovua. Ju nuk duhet ta njihni qeverinë për momentin, por të mbani kontakte me kolegun tuaj francez.”¹ Po këto udhëzime, i dhanë përfaqësive britanike në Beograd, Athinë dhe Romë. Në informacionin që Harry Eyres, i pari ministër britanik në Shqipëri, i dërgonte Sër Graham në Romë thuhej: “Opinionimi im personal është që Qeveria e Madhërisë së tij do të udhëhiqet për këtë çështje nga konsiderata se në cilën masë qeveria revolucionare do të pranohet nga populli shqiptar dhe në bazë të faktit nëse ajo do të qeverisë sipas programit të parashikuar prej saj.”² Këto dy pjesë të këtij informacioni, të cilat i kemi nënvizuar me germa italiane ishin dy nga kërkesat e rëndësishme për njohjen. Eyres pasi jepte emrat e qeverisë revolucionare të sapoformuar shtonte se: “përbërja e saj ka shkaktuar mërzitje nga ana e ‘Klikës’ dhe e ushtrisë dhe shumë pak njerëz mendojnë se do të zgjasë për shumë kohë”.³

Britanikët konstatonin se nuk kishte miratim të plotë për përbërjen e qeverisë së re. Konsulli Parr e konsideronte problematike unitetin e forcave që rrëzuan Zogun. Përveç Shkodrës, ai shtonte se edhe ‘Klika’ është tepër e pakënaqur, për shkak se nuk mori asnjë vend kryesor në

¹ *The National Archives*, London (më tej: TNA), Foreign Office (më tej: FO) 371/9639, fl. 851. Telegram i FO për Parr, mbi njohjen e qeverisë së Nolit, 18 qershor 1924.

² *Po aty*, fl. 849-850. Telegram i FO për zotin Graham (Romë), mbi qeverinë e Nolit, 20 qershor 1924.

³ *Po aty*.

qeverisje”. Madje, ai vinte në pah faktin se “Klika” ishte shumë e rrezikshme, pasi ajo akoma kontrollonte një sasi të madhe armësh dhe xhandarmërinë. Gjithashtu, si një tendencë tjetër shpërbërëse ai nënvizonte faktin se kosovarët nuk përfaqësoheshin në qeveri dhe “hyrja e Bajram Currit në Tiranë, në krye të forcave të tij, ishte kundër dëshirës së Kabinetit.”⁴

Qëndrimi negativ ndaj çështjes së njohjes së qeverisë së Fan Nolit, u përforcua me raportin e datës 22 qershor të Robert Parr-it. Atë kohë, ky i fundit, lajmëronte se “në Shqipëri luftimet po vazhdonin dhe se dëgjoheshin zëra, se pasi ishte bashkuar me dibranët, Zogu po përparonte. Në këtë çast është e pamundur të thuhet se Qeveria revolucionare mban kontrollin efektiv në mbarë vendin dhe duket se po shtohet qëndrimi kundër saj”,⁵ përfundonte Parr.

Në këtë mënyrë evidentoheshin edhe dy arsye të tjera themelore që e vinin në dyshim njohjen e shpejtë: *mospranimi i qeverisë* nga një pjesë e konsiderueshme e fuqive politike e ushtarake në vend dhe *dyshimi për mundësinë e mbijetesës së saj*.

Foreign Office (FO) u konsultua me Eyres në lidhje me njohjen dhe ky u shpreh kundër në çdo masë të saj për momentin. Ai theksoi se çdo qeveri që kishte ardhur në fuqi në Shqipëri që nga viti 1921, e kishte bërë një gjë të tillë me një pamje ligjore, kishte pasur një shumicë në parlament, ose në një shkallë tjetër, kishin qenë të pranuar prej tij. Qeveria e Fan Nolit nuk e kishte këtë shumicë dhe duket se nuk kishte ndërmend të mblidhte parlamentin. Pra, *mungesa e legjitimitetit ishte faktori më thelbësor që motivoi politikën e mosnjohjes së qeverisë britanike*.

Për të kompensuar disi këtë mangësi themelore, qeveria e Nolit shfaqti pretendimin se ajo kishte një bazë legjitimiteti pasi ishte miratuar nga Këshilli i Lartë. Foreign Office hidhte poshtë këtë spekulim të qeverisë së Nolit, e cila i shkruante kryeministrit britanik, se kishte ardhur në fuqi me anë të Regjentëve. Diplomati britanik Howard Smith shkruante: “Kjo është diçka të cilën, Z. Eyres nuk e kupton, sepse për sa ai është në dijeni, të gjithë Regjentët, me përjashtim të njërit, janë larguar

⁴ Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1924, dosja (më tej: D.) 132. Mbi njohjen e qeverisë shqiptare.

⁵ TNA, FO 371/9639, fl. 861-862. Telegram i Robert Parr për FO, mbi situatën aktuale, Durrës, 22 qershor 1924.

nga vendi dhe ai që ka mbetur është anëtar i ‘Klikës’.⁶ Këtij mendimi i bashkëngjitej edhe memorandum i përgatitur nga libraria e FO dhe opiniononi i zotit Cecil Hurst, i datës 19 qershor, të cilët tregonin se praktika e zakonshme e qeverisë britanike ishte refuzimi i njohjes formale të qeverive që kishin ardhur në fuqi me metoda revolucionare, derisa të demonstrohej qartësisht se kishin mbështetjen ose pranimin e shumicës së popullsisë.⁷

Më 7 korrik, Parr i paraqiti FO kopjen e një dekretligji të aprovuar nga qeveria revolucionare, e cila drejtohej kundër qeverisë së mëparshme dhe të gjithë atyre që e mbështetën. Ai tërhoqte vëmendjen në këto tre pika kryesore: pretendimi për të pasur juridiksion të plotë mbi shtetasit e huaj në paragrafin 7; vendimi për të konfiskuar pasuritë e personave të dënuar nga gjykata dhe faktin se aprovimi i Këshillit të Naltë është nënshkruar vetëm nga Fan Noli. Më 4 korrik, Parr kishte takuar Xhafer Vilën, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme, të cilit i tha se, “më duket e paarsyeshme që qeveria të merrte masa kaq të rrepta, kur sapo kishte ardhur në fuqi dhe se këto masa mund të sillnin shqetësime jashtë vendit.” Më tej, ai e pyeti Vilën nëse këto masa u ishin komunikuar edhe anëtarëve të kabinetit, i cili ka të paktën dy nga personat më inteligjentë në jetën publike shqiptare. Xhafer Vila e njoftoi përfaqësuesin britanik se peshkopi dhe Gurakuqi ishin dy personat në kabinet, të cilët ishin më të rreptë kundër kundërshtarëve të mëparshëm dhe se ai kishte bërë ç’ishte e mundur për t’i këshilluar të ishin më të moderuar. Ndërsa Sotir Peci, regjenti i mbetur, kishte refuzuar që të miratonte themelimin e gjykatës politike dhe si pasojë ka qenë i detyruar të heqë dorë nga funksioni i tij (formalisht të largohej për disa muaj me justifikimin e problemeve shëndetësore) dhe ta linte peshkopin të fliste dhe të vepronte në emër të Këshillit të Lartë.⁸

Qeveria britanike e vlerësoi qeverinë e re si një *qeveri revolucionare me tipare diktatoriale*. Duke iu referuar raportit të R. Parr, diplomati britanik, Howard Smith shtonte se edhe *programi i qeverisë së Nolit*, ishte tepër i pakënaqshëm. Ai e vinte theksin në artikullin 2 të programit, i cili parashikonte se, qeveria e re do të merrte masa të ashpra kundër

⁶ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 834-837. Telegram i Howard Smith dërguar FO, mbi njohjen e qeverisë së Fan Nolit, 21 korrik 1924.

⁷ *Po aty*.

⁸ *Po aty*, fl. 864-868. Telegram i Parr për FO, në lidhje me veprimtarinë e qeverisë së Fan Nolit, 7 korrik 1924.

atyre “që kanë qenë përgjegjës për trazirat”. Eyres, në lidhje me këtë, pohonte se qeveria e Iljaz Vronit nuk ishte në asnjë mënyrë përgjegjëse. Sipas tij, revolucioni u ideua nga “Klika”, e cila arriti të korruptonte ushtrinë.⁹ Si hap posaçërisht negativ të qeverisë së re, Eyres merrte faktin se, akti i parë i saj pas hyrjes në Tiranë, ishte lirimi nga burgu i personit që kishte tentuar të vriste Zogun. Në bazë të këtij hapi të qeverisë, Eyres tashmë erdhi në përfundimin se atentatori ishte vegël në duart e “Klikës”. “Shkurt, gjendja është e atillë që Qeveria e Fan Nolit është krijuar me rrugë revolucionare dhe synon të sundojë duke përdorur forcën, pa parlament dhe se do të ndiqte kundërshtarët e saj politikë”,¹⁰ përfundonte Eyres.

Përveç kësaj, nxjerrja e dekretligjit mbi themelimin e *Gjykatës për Faje Politike* nga qeveria e Nolit, u vlerësua nga FO si shenjë e karakterit të saj diktatorial por, edhe e dobësisë së saj të brendshme. Qeveria britanike, jo vetëm që nuk mund ta njihte një qeveri, e cila po vazhdonte të përdorte metoda të tilla, por mendonte se duhej të qëndronte në pritje pasi jeta e saj do të ishte e shkurtër.

Qeveria e Nolit, bëri një spastrim të thellë të administratës së mëparshme. Ky, sigurisht, ishte një veprim shtesë që plotësonte karakterin e saj diktatorial. Lidhur me këtë veprim të saj, diplomati britanik, Parr i shkruante kryeministrit të tij, MacDonald: “Ju raportoj se që nga koha kur qeveria revolucionare erdhi në fuqi, ajo ka hequr të gjithë Prefektët dhe shumicën e nën-Prefektëve, të gjithë zyrtarët më të rëndësishëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ftoi funksionarë të tjerë të rëndësishëm”.¹¹ Postet e tyre u zunë nga njerëz që kishin mbështetur revolucionin. Ata u emëruan duke u bazuar në motive politike ose në lidhjet personale. Këto masa u morën për të shpëtuar nga kundërshtarët dhe për të fituar mbështetës të dobishëm, duke siguruar në këtë mënyrë fitoren e kandidatëve të qeverisë në zgjedhje.

Pra, programi i qeverisë, karakteri i saj diktatorial, synimi për të qeverisur nëpërmjet forcës dhe për të eliminuar të gjithë kundërshtarët

⁹ *Po aty*, fl. 834-837. Telegram i Howard Smith derguar FO, mbi njohjen e qeverisë së Fan Nolit, 21 korrik 1924.

¹⁰ Zhivko Avramovski, “Qëndrimi i Anglisë ndaj Qeverisë së Fan Nolit në Shqipëri në vitin 1924”, në *Gjurmime Albanologjike*, nr. 2, Prishtinë: 1972, f. 169-170.

¹¹ *TNA*, FO 371/7330, fl. 889. Telegram i Parr për MacDonald, Kryeministër dhe Sekretar i Parë i Shtetit të Mbretërisë së Bashkuar, mbi qeverinë e Nolit, 18 gusht 1924.

politikë, ndikuan shumë në qëndrimin negativ të qeverisë britanike dhe ishin faktorë themelorë të mosnjohjes së qeverisë së Nolit prej saj.

Eyres e shqyrtonte çështjen e njohjes edhe në raport me *interesat tregtarë britanikë*. Howard Smith pohonte se, Eyres bie dakord me faktin se interesat britanikë në vend janë të vogla dhe njohja e këtij aksioni në këto momente mund të sjellë një efekt pozitiv në interesat tregtare të ardhshme të Britanisë dhe mund ta ndihmojë kompaninë “Anglo-Persian-Oil” në marrjen e koncesioneve të saj. Por, nga ana tjetër, njohja nuk do të sjellë domosdoshmërisht koncesionet dhe sipas opinionit të Eyres, ky është qëndrimi që duhet të mbajë qeveria britanike. Pra, mendohej se me njohjen, shoqëria britanike e naftës do të kishte përfitime në marrjen e koncesionit, ndonëse jo të sigurta, *por çështja e njohjes nuk shqyrtohej kryesisht në funksion të këtij përfitimi*.

Kjo çështje u diskutua edhe në takimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme, Xhaferr Vilës me përfaqësuesin britanik R. Parr. Sipas Vilës, Britania e Madhe ndiqte një politikë të qartë në të gjitha çështjet europiane dhe ai ishte i mendimit se asnjë qeveri shqiptare nuk mund të vepronte ndryshe, përveç se të ratifikonte koncesionin e kompanisë “Anglo Persian Oil”.¹² Vila në këtë takim bëri edhe një kërkesë personale, duke kërkuar që Parr të bënte ç’ ishte e mundur ta ndihmonte atë për ta bindur qeverinë revolucionare për t’u bërë më e arsyeshme. Por, Parr doli nga takimi me përshtypjen se, qëndrimi i Vilës kishte qenë komplet cinik ndaj ministrave të tij. Parr kishte bindjen se, ankthi i peshkopit për të kontaktuar me të në një moment sa më të afërt, ishte shenjë e shqetësimit për të ardhmen. Nga ana e tij, Parr mendonte se: *“përçarjet e brendshme dhe armiqtë e jashtëm do të sjellin edhe fundin e jetës së këtij kabineti brenda disa javësh*. Ai mund të zëvendësohej nga një diktaturë ushtarake, nga një kabinet tjetër i të njëjtës linjë me të ose me kthimin në fuqi të atyre që u larguan. Për këtë ekzistojnë mendime të ndryshme. I vetmi konsensus qëndron në faktin se qeveria duhet të zëvendësohet.”¹³

Duke pasur parasysh këto opinione dhe këshilla të Eyres, H. Smith sugjeronte që qeverisë shqiptare nuk i duhej dhënë njohja formale, ndërsa Parr-it i duheshin dhënë instruksione të kontaktonte me autoritetet

¹² *Po aty*, fl. 864-868. Telegram i Parr për FO, në lidhje me veprimtarinë e qeverisë së Fan Nolit, 7 korrik 1924.

¹³ *Po aty*.

shqiptare, për aq sa ishte e nevojshme në fushën tregtare. Gjithashtu, Smith e quante me interes që letrës së tij t'i bashkëngjitej edhe informacioni i fundit i marrë nga Durrësi, në formën e një letre private nga R. Parr, e datës 15 korrik, e cila tregonte se, çështja e njohjes së qeverisë së re po shqetësonte edhe disa qeveri të tjera dhe jepte një përshkrim interesant të Fan Nolit, i cili nuk shfaqej si një njeri i dëshirueshëm.

Qeveria shqiptare u informua më 26 qershor 1924, nga Mehmet Konica se qeveria britanike, ka si princip të mos njohë menjëherë qeveritë që vijnë në fuqi me dhunë. Bashkë me qeverinë e Francës vendosën të presin pak kohë për të njohur qeverinë shqiptare. Ai veçonte çështjen e liritimit nga burgu të atentatorit të A. Zogut, Beqir Valterit si një veprim që kishte bërë përshtypje tejet negative në Londër. Konica pohonte se në Foreign Office, pas lajmeve të sigurta, u mor vesh se qeveria shqiptare liroi njeriun që plagosi Ahmet Zogun. “Në është se ky njeri u lirua me të vërtetë, deklaronte Konica, këtë do ta ketë bërë ndonjë oficer i nxehur kur hyri ushtria në Tiranë po jo Guverna e regullshme, miset e te cilës kanë patur kurdoherë për princip dënimin e vrasjes dhe punitjen e vrasësve dhe cenimi i këtij principi që një nga shkaqet që provokuan kryengritjen.”¹⁴

Qëndrimin realist dhe konsekuent të qeverisë britanike, nuk e kuptuan krerët e qeverisë dhe madje as ministri shqiptar në Londër, Mehmet Konica, i cili ishte një diplomat i shquar dhe me përvojë. Qeveria shqiptare i dërgoi një telegram tjetër qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar, ku i kërkohej njohja e kësaj qeverie. Por, risia e këtij telegrami, i cili mbante datën 14 korrik 1924, ishin akuzat që bëheshin ndaj përfaqësuesit të Britanisë së Madhe në Shqipëri, H. Eyres, për faktin se ai kishte qenë identifikuar me qeverinë e mëparshme dhe nuk mund të jepte një opinion të paanshëm.

Letra e Mehmet Konicës, dërguar Kryeministrit dhe Sekretarit të Shtetit për Punët e Jashtme të Britanisë së Madhe, James Ramsay MacDonald, kishte një ton aspak diplomatik dhe përshkohej nga një frymë ideologjike dhe jorealiste. Ndër të tjera, në të thuhej se, qeveria britanike kishte njoftuar se nuk do ta njihje qeverinë e re shqiptare, për sa kohë ajo nuk kishte marrë votëbesimin nga Asambleja Kushtetuese. “Ky pohim i çuditshëm i përfaqësuesit tuaj, do të thotë rivendosje e kabinetit

¹⁴ AMPJ, V. 1924, D. 132. Mbi njohjen e qeverisë shqiptare.

të mëparshëm feudal, shfuqizimin e ligjeve dhe rregullave, sanksionimin e një shteti skllavërues ndaj popullit dhe përfundimisht asistimin në shpërbërjen e Shqipërisë”,¹⁵ shkruante Konica. Më tej, në letrën e tij, ai shpjegonte faktin se, Fan Noli i kishte kërkuar t’i shpjegonte se njohja e menjëhershme e qeverisë së re shqiptare nga Britania e Madhe, do të kishte rëndësi të madhe në zbatimin e reformave sociale dhe ekonomike, të cilat formonin bazat e programit. Mosnjohja do të ishte një armë e rëndësishme në duart e të ashtuquajturve feudalë dhe një inkurajim indirekt për ta për t’u rikthyer në fuqi. “Ju kujtoj se kjo qeveri është krijuar në bazë të vullnetit të lirë të popullit dhe të dhënat e mëparshme të liberalëve janë një provë”, citonte Konica. “Jam i frikësuar nëse qeveria britanike, do të vendosë mbi bazën e vlerësimit të përfaqësuesit të saj, në lidhje me krijimin dhe sjelljen e qeverisë shqiptare, njohja në këtë rast do të shtyhej pafundësisht. Me keqardhje dëgjoj se përfaqësuesi i qeverisë britanike ka këshilluar qeverinë e fundit të vazhdojë rezistencën e saj dhe ky ka qenë shkak i humbjeve të jetës dhe parave.”¹⁶ Mendojmë se ky nuk ishte stili i komunikimit të M. Konicës, i cili kishte një përvojë të madhe në çështjet diplomatike por, stili i komunikimit të vetë Nolit ose i diktuar prej tij. Gjithsesi, siç e pamë edhe më lart, kjo mënyrë komunikimi më tepër e pengoi njohjen se sa i shërbeu asaj.

Smith e shqyrtoi letrën e Mehmet Konicës adresuar qeverisë britanike dhe sugjeronte që ajo nuk duhej pranuar në asnjë mënyrë. “Jo vetëm sepse është shumë fyese për sa i përket tonit të saj, por sepse bën edhe një akuzë të pavërtetë për përfaqësuesin e qeverisë britanike në Shqipëri”. Eyres-i ka mohuar tërësisht faktin e pretenduar se ai ka mbështetur qeverinë e Iljaz Vrionit në përpjekjet e saj kundër revolucionit. Ai ishte i mendimit se qeveria (e I. Vrionit) ishte mjaft e dobët, por e gjitha çfarë ai ka shprehur në apelin e tij është: “qeveris ose largohu”. Ai nuk i ka këshilluar ata të qëndronin apo të rezistonin. Smith sugjeronte se e vetmja rrugë për t’u ndjekur nga z. Konica është tërheqja mbrapsht e letrës së tij, me informacionin se kryeministri, refuzonte të kishte komunikim, edhe atë të një natyre private, me persona të cilët

¹⁵ TNA, FO 371/7330, fl. 840-842. Letër e Mehmet Konicës dërguar MacDonald, mbi njohjen e qeverisë së Nolit, 14 korrik 1924.

¹⁶ *Po aty*.

“bënin akuza të pajustificueshme, kundra përfaqësuesve të Qeverisë Britanike në botë”.¹⁷

Më 30 korrik, qeveria britanike njoftoi, si më poshtë, Mehmet Konicën, mbi çështjen e njohjes së qeverisë së Fan Nolit: “Praktika e qeverisë britanike është mos dhënia e njohjes për një qeveri të huaj, e cila ka ardhur në fuqi si rezultat i një lëvizjeje revolucionare, derisa kjo qeveri të përfaqësojë vullnetin e shprehur të popullit të saj dhe të tregojë se është e pranuar nga shumica e vendit. Informacioni që ka në dispozicion kjo qeveri, nuk tregon se kemi të bëjmë me një rast të tillë”¹⁸, përfundonte telegrami.

Foreign Office vijoi të ishte kritik ndaj Nolit madje edhe ndaj gjithë klasës politike shqiptare. Në FO kërkonin që Fan Noli të provonte se opinionin i pafavorshëm i Eyres ishte i gabuar. Nga ana tjetër, thuhej se qëndrimi i Eyres, nuk kishte lidhje me hezitimin e FO për të njohur qeverinë e re si një qeveri legale shqiptare. Arsyeja e vërtetë ishte fakti se “ne nuk mund ta njohim një qeveri si ‘legale’, derisa ajo të ndërmarrë disa hapa që tregojnë se ajo është përfaqësuesja e shumicës së popullit.” Në këtë kontekst, FO vinte në dukje se, dhoma e Parlamentit Shqiptar ishte e shpërbërë dhe derisa ajo të mblidhej ose të mbaheshin zgjedhje të reja, “ne s’mund ta njohim qeverinë e re *de jure*, kur në fakt, ajo nuk ka fare status konstitucional”. Edhe pse Fan Noli mund të përgjigjet se institucionet përfaqësuese janë të papërshtatshme për Shqipërinë dhe se ai nuk do ketë mundësi të mbajë zgjedhje, derisa qeveria e tij të njihet nga Fuqitë e Mëdha, deklaronte FO, “kjo, është thjesht pikëpamja e tij personale dhe nuk ndikon në qëndrimin tonë kundrejt kësaj qeverie.”¹⁹

Në bazë të raporteve të përfaqësuesve të vet, FO arriti në përfundimin se, qeveria e Fan Nolit nuk e kishte shtrirë pushtetin në mbarë vendin; kishte indikacione që kjo nuk do të mbante qëndrime prej një qeverie të qytetëruar si dhe pritej që ajo të bënte reprezalje, prandaj vendimi mbi njohjen, apo përgjigjja e mesazhit të Fan Nolit, dërguar kryetarit të qeverisë angleze, MacDonaldit, duhej të shtyheshin. “*Ne nuk*

¹⁷ *Po aty*, fl. 834-837. Telegram i Howard Smith dërguar FO, mbi njohjen e qeverisë së Fan Nolit, 21 korrik 1924.

¹⁸ *Po aty*, fl. 860-861. Telegram i FO dërguar Mehmet Konicës, mbi qeverinë e Fan Nolit, 30 korrik 1924.

¹⁹ *Po aty*, fl. 880-882. Situata shqiptare, 28 gusht 1924.

kemi nevojë të ngutemi. Qeveria e re po shihet se tani për tani nuk ka bazë solide”, shprehej kryeministri britanik.²⁰

Më vonë, shpejtësia me të cilën u rrëzua Fan Noli, tregoi se vlerësimet e diplomatëve dhe të qeverisë britanike mbi kundërthëniet e brendshme që po dobësonin fuqinë e regjimit të tij, ishin të sakta. Këtu, duhet konstatuar se, edhe refuzimi i qeverisë angleze që ta njihte qeverinë e Fan Nolit, objektivisht ishte faktor shumë qenësor në dobësimin e saj dhe shpejtonte rënien. Në këtë situatë marrja e një kredie të huaj, që ishte një çështje jetësore, u refuzua për shkak se qeveria nuk ishte njohur si qeveri e ligjshme shqiptare.²¹

Gabimeve të shumta iu shtua edhe një fenomen i ri negativ, i cili nuk ishte konstatuar më parë. Si rezultat i dështimit në sigurimin e njohjes ndërkombëtare, qeveria, me ose pa dashje, nxiti edhe një *fushatë akuzash kundër të huajve, kryesisht kundër vendeve perëndimore*. Më 30 korrik, Robert Parr informonte kryeministrin MacDonald: “Ju raportoju se gjatë javëve të kaluara ka pasur disa indikacione të një ndjenje të përgjithshme armiqësie kundrejt të huajve në këtë vend...” Ai deklaronte se kishte pasur sulme mjaft të dhunshme në shtyp, kundrejt një sërë vendesh fqinje të Shqipërisë si dhe ndaj Francës dhe Britanisë. Këto ishin karakterizuar gjerësisht nga bindja se Shqipëria është një vend i lirë dhe një shtet i pavarur dhe për pasojë, mund të jetë sulmuese ndaj çdo vendi tjetër. Sulme të tilla janë mbështetur nga një sërë njerëzish, madje edhe drejtues të niveleve të larta e të ulëta të qeverisë revolucionare dhe gjithashtu edhe njerëz me përgjegjësi. “Ministri i P. të Brendshme, për shembull, gjatë vizitës së fundit në Durrës, përdori një gjuhë arrogante kundrejt Francës dhe Britanisë”²². Parr ishte në dijeni se kohët e fundit po vihej re një propagandë kundër shkollës amerikane, pasi mësimi në këtë shkollë ishte kërcënim për besimin në Shqipëri. Gjithashtu, qeveria revolucionare, kishte sjellë një sërë pengesash për koncesionet e huaja në Shqipëri. Në rastin e koncesionit të Zvicrës, qeveria e re refuzoi të implementonte vendimet e marra nga paraardhësja e saj, në lidhje me koncesionarët.

²⁰ Zh. Avramovski, “Qëndrimi i Anglisë ndaj Qeverisë së Fan Nolit ...”, f. 163-166.

²¹ Po aty, f. 181-182.

²² TNA, FO 371/9644, fl. 1439-1442. Telegram i Parr për MacDonald, mbi qëndrimin armiqësor të qeverisë shqiptare ndaj të huajve, 30 korrik 1924.

Analizat e diplomatëve britanikë mbi gjendjen në vend gjatë qeverisjes së Fan Nolit

Pikësëpari, përfaqësuesit britanikë vlerësuan në mënyrë tepër kritike por, për mendimin tonë realiste, *kryengritjen e qershorit* që solli në pushtet Fan Nolin. Në një raport për qeverinë britanike, Eyres zbulonte se, arsyeja e vërtetë për revoltën ishte dëshira për të shpëtuar nga Ahmet Zogu. Edhe pse ky i fundit nuk ishte në qeveri, ai konsiderohej si fuqi pas fronit. “Forcat e armatosura dhe ‘Klika’, të cilët dëshironin të qeverisnin sipas metodave të tyre vrastare, asnjëherë nuk do të ndiheshin të sigurtë për fuqitë e tyre, për sa kohë Ahmeti do të ishte në pozita për t’i kundërshtuar ato”²³, pohonte Eyres. Ministri britanik, përcaktonte “Klikën” si shtyllën e kryengritjes së qershorit dhe nënvizonte dëmin e madh politik që i shkaktoi ajo vendit. Zogu, në vlerësimin e tij, ishte i vetmi që mund t’i pengonte ata në këto qëllime të errëta, prandaj edhe goditja ishte drejtuar kundër tij. Eyres, në vazhdim, analizonte edhe përkrahësit e tjerë rastësorë të kësaj kryengritjeje, komentonte përbërjen e qeverisë dhe të grupeve që erdhën në pushtet. Ai shkruante: “Sa për krijesat e varfra, që mendojnë se janë nacionalistë dhe janë duke luftuar për një qeverisje popullore, ato janë thjesht, mishërimi i njerëzve më të pamëshirshëm dhe të dëshpëruar, që po luajnë vetëm për veten e tyre.”

Që më 10 qershor, ai shkruante edhe për *përçarjen e thellë* midis forcave kryengritëse dhe jepte fakte se deri ku shkonte kjo përçarje. Sipas tij, Shkodra ishte politikisht dhe mendërisht e ndarë nga Jugu. Shkodranët u bashkuan me rebelët, sepse shpresonin të përfitonin avantazhe për krahinën e tyre. Programi i tyre përfshinte transferimin e kryeqytetit dhe të Asamblesë në Shkodër. Në fakt, shprehej Eyres: “*ndarja mes gegëve dhe toskëve, është më e theksuar se kurrë. Është shumë e vështirë të shohësh sesi interesa të ndryshme konfliktuale mund të pajtohen.*”²⁴ Po kështu informonte edhe Parr, i cili theksonte se qeveria revolucionare nuk ka pasur sukses në lehtësimin e mosmarrëveshjeve të “Klikës” dhe të partisë kosovare dhe se ekzistonte një përçarje mes kryengritësve shkodranë dhe atyre vlonjatë.²⁵

²³ *Po aty*, FO 371/9639, fl. 829. Telegram i Eyres për MacDonald mbi ngjarjet e fundit, Durrës, 10.06.1924.

²⁴ *Po aty*.

²⁵ *Po aty*, fl. 861-862. Telegram i Parr, mbi qeverinë shqiptare, 22 qershor 1924.

Pikërisht, në ditën e triumfit të kryengritjes, ministri britanik në Shqipëri, Harry Eyres e vlerësonte krejtësisht me ngjyra të zymta situatën e krijuar. Ai informonte kryeministrin britanik se “*Qeveria aktuale është e dobët, e ndarë në grupe dhe elementët shkatërrimtarë kanë marrë avantazh për këtë fakt*”,²⁶ ndërsa vetëm pak ditë më vonë, një tjetër diplomat britanik, njoftonte se qeveria revolucionare nuk kishte kontroll aktiv mbi të gjithë vendin dhe ndjenjat kundër saj po rriteshin. “*E kuptoj se ata nuk do ta mbledhin Parlamentin*”,²⁷ deklaronte Parr.

Eyres kishte ardhur në përfundimin se situata e Shqipërisë ishte e rrezikshme. Ai mendonte se nuk kishte mbetur asnjë alternativë tjetër për të ndaluar konfliktet e pareshtura dhe shpërbërjen e Shqipërisë, përveç vendosjes së një diktature personale me në krye A. Zogun. Sipas tij, një diktaturë me Ahmet Zogun që në fillim, mund ta shpëtonte situatën, por kjo nuk ishte praktike dhe jeta e tij do të ishte gjithmonë në rrezik. Eyres ishte i vetëdijshëm se një fraksion do të kishte sukses mbi tjetrin dhe qeveria gjithmonë do të ishte e dobët dhe joefektive.

Në procesin e qeverisjes, diplomatët britanikë konstatuan edhe rritjen e pakënaqësisë së popullsisë kundër saj. Në fillim të shtatorit Parr deklaronte: “*Është e jashtëzakonshme të shohësh se me sa shpejtësi qeveria aktuale ka fituar jopopullaritet universal*”.²⁸ Ai e shpjegonte këtë me faktin se, secila nga të tre partitë që u bashkuan për kryengritjen, kishin qëllime të ndryshme dhe duke parë që dy të tjerat, janë në çdo rast kundër arritjes së objektivit të së tretës, janë acaruar nga fakti që ishin të paaftë të realizonin çfarëdolloj politike dhe nga frika që kishin nga hija e Ahmet Zogut.

Rreth dy javë më vonë edhe Eyres, njoftonte se situata mbetej e njëjtë. Ai konstatonte se, ministrat kishin synime të ndryshme por, të gjithë i bashkonte dëshira për të mbajtur postet e tyre. Eyres kishte zhvilluar biseda me disa ministra dhe me politikanë të spikatur të të gjitha partive. Ai informonte Foreign Office se: “*Çdo parti ia hedh fajin tjetrës*

²⁶ *Po aty*, FO 371/9644, fl. 1290-1293. Telegram i Eyres për Macdonald, Durrës, 10 qershor 1924.

²⁷ *Po aty*, FO 371/9639, fl. 861-862. Telegram i Parr, mbi qeverinë shqiptare, 22 qershor 1924.

²⁸ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 897-901. Telegram i Eyres për MacDonald, 2 shtator 1924.

për revolucionin dhe pasojat e tij” dhe se “ky revolucion i kotë nuk krijoi asgjë, por solli vetëm grindje dhe të pakënaqur.”²⁹

Ndryshe nga sa është shkruar në ndonjë rast, se *përfaqësuesit britanikë kishin tendenca armiqësore kundrejt qeverisë*, nga dokumentet britanike rezulton se ata edhe asaj, ashtu si qeverive të mëparshme, i *dhanë këshilla miqësore dhe të vlefshme për qeverisjen dhe stabilizimin e situatës*. Ndonëse ishte kritik për veprimet e qeverisë së Nolit, përfaqësuesi britanik u përpoq t’i këshillonte krerët e saj të bashkoheshin rreth një ideali të vetëm dhe të përbashkët duke pasur parasysh të mirën e Shqipërisë. “U thashë atyre se, për sa kohë që ata nuk lënë mënjane qëllimet e tyre personale dhe nuk bashkohen që të formojnë një qeveri për të mirën e përgjithshme, ata po dëmtojnë të ardhmen e Shqipërisë si një shtet i pavarur.”³⁰ Eyres pohonte se, ata ranë dakord për këtë gjë, po nuk kishin shpresë se kjo pikëpamje do të gjente zbatim, pasi situata ishte e zymtë në ekstrem. Eyres, që në këtë kohë, supozonte se në qoftë se veriu do të bashkohej me Ahmet Zogun, do të sigurohej një pushtim i suksesshëm. Gjithashtu, ai konstatoje se midis popullsisë në këto momente nuk kishte dëshirë për të marrë armët dhe se nuk kishte një entuziazëm real për një lider apo për një parti. Ai mendonte se situata mund të qëndronte në *status quo*, përderisa qeveria i kishte lodhur tërësisht shqiptarët me dobësinë dhe paaftësinë e saj.

Përfaqësuesit britanikë, konstatuan anarkinë dhe përkeqësimin drastik të sigurisë së brendshme gjatë qeverisjes së Nolit dhe kanë lënë dëshmi shumë interesante për këtë.

Eyres raportonte se, që kur Fan Noli erdhi në fuqi, kushtet u bënë gjithmonë e më të këqija. Shtypi raportonte pothuajse çdo ditë vjedhje në rrugë dhe vrasje. Banda të vogla banditësh duket se ekzistonin në një numër të konsiderueshëm krahinash. Policia dhe xhandarmëria ishin pothuajse joefektive.³¹ Një tjetër shenjë e kësaj kohe ishte rifillimi i gjakmarrjes. Për shkak të kryengritjes një numër i madh njerëzish kishin armë zjarri. Për pasojë, puna e suksesshme e Ahmet Zogut në këtë drejtim, i cili i reduktoi vrasjet për gjakmarrje në 70-80 %, mund të thuhet se u shpërbë tërësisht.³² Sipas tij, format lokale të martesave me

²⁹ *Po aty*, fl. 916-917. Telegram i Eyres për MacDonald, 18 shtator 1924.

³⁰ *Po aty*.

³¹ TNA, FO 371/9643, fl. 3113-3114. Raport i Eyres për MacDonald, mbi situatën në Shqipëri, Durrës, 26 tetor 1924.

³² *Po aty*.

rrëmbim, u kthyen në modë në vendet malore. “Praktikisht vendi tashmë ka ecur mbrapa edhe në krahasim me kushtet që ekzistonin nën regjimin turk”, pohonte Eyres. Megjithatë, ka një diferencë, shtonte ai: ‘Nën administrimin turk, masa e popullsisë nuk ndjente keqardhje për mungesën e sigurisë, ndërsa sot, rregulli i fortë i Ahmet Zogut kujtohet me aprovim’.³³ Si tregues të dobësisë së qeverisë në përballjen me këto çrregullime, ai rendiste edhe faktin se vetë Tirana nuk bënte përjashtim. Të shtëna të vogla ishin të shpeshta në qytet, sa edhe rezidenca e kryeministrit nuk ishte e garantuar prej tyre. “Në një bisedë që pata me Fan Nolin, ai më dha të kuptoja se nuk dinte se si do t’i përballonte problemet e shumta me të cilat po ballafaqohej”³⁴, raportonte ministri britanik.

Përçarjet e brendshme dhe rigjallërimi i tendencave partikulariste, u shfaqën edhe në *Kongresin Arsimor*, që organizoi qeveria e Nolit. Kongresi, siç e përshkruante Robert Parr, “ishte një dështim i plotë”.³⁵ Ai pohonte se “katolikët erdhën me propozimin se sistemi aktual nuk i përgjigjet diferencave fetare dhe duhet të abrogohet dhe të vendoset një sistem me shkolla të një sektit të caktuar. Ky sugjerim u kundërshtua nga myslimanët. Sipas tyre, theksimi i diferencave fetare mes nxënësve do të dëmtonte unitetin në vend. Pjesërisht, si rezultat i kësaj, acarimet fetare janë shumë të larta për momentin në Tiranë”. Por, Parr shtonte edhe një fakt tjetër, tepër interesant. Ai akuzonte “Klikën” se po përpiquej ta shfrytëzonte këtë situatë fatkeqe për interesat e saj të ngushta. ‘Klika’, siç mund të pritej, po përpiket në mënyrë të pandershme të përfitojë politikisht nga kjo situatë dhe po përhap fjalë se qeveria është tërësisht në duart e ‘qafirëve’, se anëtarët myslimanë të kabinetit, Rexhep Shala dhe Kasem Qafëzezi, janë sa për figurë, për të qetësuar opinionin mysliman dhe se me një kryeministër të krishterë si Fan Noli, mund të shkohet drejt katastrofës.”³⁶

Eyres e analizonte edhe më gjerësisht gjendjen e krijuar në një raport për MacDonald, më 26 tetor 1924. Ai, duke konfirmuar raportimet e veta të mëparshme, mbi mungesën e sigurisë së përgjithshme në Shqipëri dhe dështimin e qeverisë revolucionare për të siguruar rendin publik, pohonte

³³ *Po aty*.

³⁴ *Po aty*.

³⁵ *Po aty*, FO 371/9644, fl. 1448-1449. Telegram i Parr për MacDonald, 19 gusht 1924.

³⁶ *Po aty*.

se kjo situatë kishte filluar që në momentin kur Ahmet Zogu dha dorëheqjen. Ai kishte qenë gjithmonë një dorë e fortë në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe diferenca u ndje kur Zogu ia dorëzoi kabinetin Shefqet Vërlacit. *“Efektet e para ishin kryesisht tendencat e një pjese të xhandarmërisë për të abuzuar me pozitën e tyre dhe një dobësi e përgjithshme administrative, e cila e lejoi ‘Klikën’ të kënaqej me terrorizmin politik.”*³⁷ Është me rëndësi të rikujtojmë se një nga akuzat, me të cilat u padit qeveria e mëparshme, nga liderët revolucionarë, ishte fakti se ata nuk mund të mbanin qetësinë në vend.

Diplomatët britanikë konstatuan edhe përpjekjet që po bëheshin për një grusht shteti nga një pjesë e “Klikës” për të përmbysur qeverinë e Nolit dhe për të krijuar një qeveri tjetër. Më 18 gusht, Robert Parr, jepte një informacion interesant për faktin se si qeverisë së Nolit po i rreshqiste toka nën këmbë dhe se si “Klika” po avanconte drejt pushtetit. Ai i shkruante MacDonald: *“Njerëz të caktuar po bashkohen në mënyrë të hapur me ‘Klikën’... mund të ketë pak dyshim se ata po planifikojnë një coup d’etat”.*³⁸

“Klika”, jo vetëm që e kishte projektuar grushtin e shtetit, por kërkoi edhe mbështetjen e qeverisë britanike, për realizimin e tij. Robert Parr, më 21 gusht, njoftonte Nicolson, se atë mbrëmje kishte pasur një vizitë nga një shqiptar, të cilin e njihte mjaft mirë. Ai i tha Parr se ishte caktuar nga dy liderët më të spikatur (të “Klikës”) për të diskutuar me të qëndrimin e qeverisë së Madhërisë së tij kundrejt një *“coup d’etat”* të “Klikës”. Më tej, i dërguari i “Klikës” vijoi t’i tregonte atij se drejtuesit e saj i kishin thënë që e gjithë situata ishte e patolerueshme dhe se diçka duhej bërë për t’u bërë ballë katolikëve dhe ortodoksëve. Për drejtuesit e “Klikës” Fan Noli, në të vërtetë, nuk kishte shumë rëndësi. *“Ai është një i huaj dhe nuk ka mbështetës në vend”.*³⁹ Për ta, Gurakuqi me katolikët ishte rreziku kryesor, sepse ai mbështetej nga Rexhep Shala dhe Mustafa Kruja. I dërguari i “Klikës” i tha Parr se “drejtuesit e saj i kanë dërguar një ultimatum qeverisë dhe shpresojnë që së shpejti të mblidhen në Tiranë dhe të bëjnë ‘coup d’etat’, të ngjashëm me atë me të cilin u rrëzua

³⁷ *Po aty*, FO 371/9643, fl. 3113-3114. Raport i Eyres për MacDonald, mbi situatën në Shqipëri, Durrës, 26 tetor 1924.

³⁸ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 884-887. Telegram i Parr dërguar MacDonald për “Klikën”, Durrës, 18 gusht 1924.

³⁹ *Po aty*, fl. 906-908. Telegram i Parr për Nicolson, mbi kërkesën e “Klikës” për faktin që qeveria britanike mbështeste një forcë politike në vend, 21 gusht 1924.

qeveria e Pandeli Evangjelit. Pas ‘coup d’etat’, ata do të mbajnë zgjedhjet, ku do të fitonte favoritja e qeverisë së Madhërisë së tij.”⁴⁰

Po kaq interesant është fakti se britanikët u përpoqën ta dekurajonin këtë përpjekje,⁴¹ ashtu siç kishin bërë më parë me tentativat për grusht shteti në nëntor 1923 dhe me ato të maj-qershorit 1924. Parr e kundërshtoi këtë ide dhe i tha të dërguarit të “Klikës” se qeveria e Madhërisë së tij, në asnjë mënyrë nuk ishte e interesuar për asnjë parti politike në vend dhe se asgjë nuk do të ishte më qesharake se supozimi se ajo do të hynte në marrëveshje me një organizatë të çfarëdo lloji qoftë.⁴² Gjithashtu, Parr konfirmoi edhe një herë qëndrimin konsekuent të qeverisë britanike për të ndihmuar unitetin politik, stabilitetin dhe qeverisjen legale në Shqipëri. Parr i tha bashkëbiseduesit të tij se, “gjithë kjo bisedë mbi fituesin e pëlqyer prej qeverisë së Madhërisë së tij është e pakuptimtë dhe se ata duhet ta kuptojnë një gjë të tillë. Qeveria e Madhërisë së tij do të shohë me dashamirësi çdo qeveri të përshtatshme në Shqipëri, e cila do të përpiqet me të vërtetë ta ndihmojë vendin të eci me këmbët e tij, por do të jetë gjithmonë e përmbajtur ndaj intrigave të fraksioneve. Në qoftë se disa njerëz, apo një parti, duan ta fitojnë këtë mbështetje, rruga e tyre më e mirë do të ishte zbehja e të gjitha diferencave mes Jugut dhe Veriut dhe bashkëpunimi midis tyre”.⁴³ Përfaqësuesi britanik e bëri të qartë se, për sa kohë ata do të distancoheshin nga grindjet politike, fetare dhe raciale, do kishin miratimin dhe mbështetjen britanike dhe të çdo fuqie tjetër të civilizuar.⁴⁴ Përkohësisht fjala e diplomatit britanik e stepi “Klikën” por, tendenca e saj për grusht shteti, siç do të shohim më tej, nuk u shua.

Me zbehjen e mëtejshme të shpresave për efektivitetin e qeverisë së Nolit dhe me afrimin e momentit të zgjedhjeve, pikërisht në dhjetëditëshin e dytë të tetorit, “Klika” iu drejtua sërish opsionit të grushtit të shtetit. Përfaqësia britanike, më 20 tetor, informonte Londrën se ‘Partia Nacional-Demokrate’ kishte kontaktuar dhe Nolin, të cilit, i kishte kërkuar ndryshimin e qeverisë. Grupi, i cili tani e cilësonte veten si ‘Partia Demokrate-Nacionale’, konsistonte në ‘Klikën’ e vjetër, me disa pasues shtesë, që kishte qenë i aftë t’i fitonte. Ai kishte mbajtur një

⁴⁰ *Po aty.*

⁴¹ *Po aty.*

⁴² *Po aty.*

⁴³ *Po aty.*

⁴⁴ *Po aty.*

mbledhje dhe, si rezultat, kishte dërguar një komitet për t'u këshilluar me kryeministrin. Komiteti i deklaroi Nolit se “shpresat e ngjallura nga revolucioni janë zbehur, pasi qeveria nuk ka bërë asgjë dhe se, në asnjë mënyrë, nuk i ka përmbushur premtimet e saj. Anarkia mbizotëron në vend dhe siguria publike është zvogëluar në një masë të madhe”.⁴⁵ Për pasojë, ata i kërkuan kryeministrin, që të rimodelonte kabinetin, duke pranuar dy ose tre anëtarë të “Partisë Demokrat-Nacionale” dhe shkarkimin e atyre ministrave që ishin të papranueshëm për ta. Në qoftë se ai nuk do ta pranonte sugjerimin e tyre, ata do të kërkonin dorëheqjen e tij. Nga ana e tyre, diplomatët britanikë, ripërsërisnin se, “Partia Demokrat-Nacionale” kishte si qëllim që të thërriste Ahmet Zogun, pasi nuk e ndjenin pozitën e tyre aq të sigurt, pa ndihmën e tij.⁴⁶

“Klika” përsëriti thirrjet drejtuar diplomatëve britanikë për t'i mbështetur në realizimin e grushtit të shtetit. Eyres ritheksonte: ‘Partia Demokrat-Nacionale’ më është drejtuar indirekt disa herë për t'i mbështetur.”⁴⁷ Të gjitha këtyre kërkesave ai u ishte përgjigjur me qartësi dhe vendosmëri, se qeveria e tij sigurisht që nuk do ta shihte të favorshëm një veprim të tillë dhe se ai nuk kishte ndërmend ta fuste veten në intriga politike. Ai i kishte këshilluar sërish se metoda e vetme për të fituar aprovimin e Britanisë së Madhe, ishte zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis tyre dhe përpjekjet e përbashkëta për të themeluar një administrim të mirë.⁴⁸

Këtë herë jo vetëm këshillat britanike por, edhe pasiguria e “Klikës” se do të dilte fituese nga një grusht i ri shteti e detyruan atë ta braktiste këtë rrugë, të paktën përkohësisht. Eyres informonte MacDonald: “qeveria iu përgjigj kërkesës së ‘Partisë Demokrat-Nacionale’ se ajo nuk ishte e përgatitur të pranonte rikonstruktimin e kabinetit dhe as të jepte dorëheqjen. Në fakt Imzot Fan Noli sfidoi ‘Klikën’.”⁴⁹ Për pasojë, ‘Partia Demokrat-Nacionale’ mbajti një mbledhje ku mori pjesë edhe ministri i Luftës, Kasem Qafëzezi. Ky i fundit, mendohej se e kishte lidhur veten me këtë parti”, theksonte Eyres: “por nëse është kështu, atëherë ai është

⁴⁵ TNA, FO 371/ 9640, fl. 1916-1918. Telegram për MacDonald mbi gjendjen në Shqipëri gjatë qeverisjes së Nolit, Durrës, 20 tetor 1924.

⁴⁶ *Po aty.*

⁴⁷ *Po aty.*

⁴⁸ *Po aty.*

⁴⁹ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 943-944. Telegram i Eyres për MacDonald mbi zgjedhjet në Shqipëri, 23 tetor 1924.

një partizan me gjysmë zemrë”. Në rastin konkret, ai e këshilloi partinë të vepronte në mënyrë të moderuar, ndryshe “çdo gjë e natyrës së *coup d’etat* do të shoqërohej nga një gjakderdhje e rrezikshme në Tiranë”.⁵⁰ K. Qafëzezi u kishte thënë se ministri i Punëve të Brendshme ishte duke marrë masa për këtë rast dhe do të mbështetej fuqimisht nga malësorët. Kjo këshillë, pati një efekt të konsiderueshëm dhe eventualisht u vendos të braktisej çdo përpjekje për të përdorur forcën deri në zgjedhje.⁵¹ Nga burimet britanike rezulton se “anëtarët e opozitës së vjetër, të cilët ishin përkohësisht fraksioni më dominues”, ishin mbledhur në “Partinë Radikal-Demokrate”, e cila përbëhej nga shoqëria “Bashkimi”, partia e klerit të Shkodrës dhe pjesa tjetër, nga deputetët që ishin kundër qeverisë së Ahmet Zogut.⁵²

Një problem tjetër që e thellonte përçarjen në radhët e “revolucionarëve” ishte *pakënaqësia e madhe që po akumulohet në popullsinë e Shkodrës kundër qeverisë*.

Këtë situatë, përveç britanikëve, e konfirmonin edhe përfaqësuesit italianë. Konti Marchetti, përfaqësuesi i legatës italiane, kishte bërë një vizitë në Shkodër në fund të korrikut. Pas kthimit, ai i tha Parr-it se kishte krijuar përshtypje të zymta në lidhje me zhvillimet e mundshme në të ardhmen. Ai e kishte gjetur qytetin në një gjendje ngazëllimi, ku diskutohej çështja nëse qeveria revolucionare do të vendoste ta themelonte këtu kryeqytetin apo në një qytet tjetër të Shqipërisë. Në qoftë se nuk do të zgjidhej Shkodra, populli i këtij qyteti do të merrte të gjitha masat e mundshme, duke mos përjashtuar as kryengritjen e armatosur, për të kundërshtuar qeverinë dhe për të realizuar dëshirën e tij.⁵³ Marchetti gjithashtu kishte parë se ndjenjat fetare ishin acaruar në të vërtetë shumë, aq sa ai parashikonte edhe përplasje me armë mes katolikëve dhe myslimanëve.⁵⁴ Edhe diplomati italian mbështeste krejtësisht opinionin e Parr-it se jeta e qeverisë së Nolit do të ishte shumë e shkurtër dhe se do të zëvendësohej nga një diktaturë ushtarake në varësi të “Klikës”, e cila, nga ana e saj, dukej se nuk do të kishte jetëgjatësi.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*.

⁵² *Po aty*, FO 371/ 9640, fl. 1916-1918. Telegram për MacDonald mbi gjendjen në Shqipëri gjatë qeverisjes së Nolit, Durrës, 20 tetor 1924.

⁵³ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 872-873. Telegram i Parr për MacDonald, mbi opinionin publik në vend në lidhje me qeverisjen e Fan Nolit, 2 gusht 1924.

⁵⁴ *Po aty*.

Parr njoftonte gjithashtu Londrën se ky ishte, pak a shumë, mendimi i të gjithë trupit diplomatik në Shqipëri. Ky opinion, përforcohej edhe nga fakti se thashethemet kundra qeverisë aktuale dhe profecitë se rënia e saj ishte e afërt nuk po zvogëloheshin. *“Njerëzit janë në një gjendje pasigurie. Siguria publike nuk është e realizuar. Njerëzit i frikësohen të ardhmes dhe ka nga ata të cilët, ndonëse e cilësojnë veten armiq të Zogut, deklarojnë se do të pranoinin përsëri qeverisjen e tij, kundrejt asaj që kishin tani”*⁵⁵, përfundonte Parr.

Të njëjtin informacion dhe pikëpamje për gjendjen në Shkodër dhe për përçarjen e thellë që ekzistonte brenda vendit, kishte edhe përfaqësuesi francez. Eyres informonte qeverinë e tij se më 31 gusht, R. Parr, kishte qenë në Shkodër ku ishte takuar me Të ngarkuarin me Punë të qeverisë franceze, me të cilin kishte diskutuar në përgjithësi mbi situatën. Në këtë takim, Billecocq kishte theksuar: *“Ndjenja që mbizotëronte në Shkodër dhe në distriktet e saj, ishte ajo e një zhgënjimi të thellë me regjimin e ri dhe me ndjenjë fyerje për shkak të mbështetjes që i kanë dhënë”*.⁵⁶ Sipas përfaqësuesit britanik dhe atij francez, liderët e revolucionit i kishin bindur veriorët të bashkoheshin me ta, nëpërmjet premtimit për të vendosur kryeqytetin në Shkodër, premtim të cilin, ata nuk kishin pasur asnjëherë si qëllim që ta përmbushnin. Shkodranët kishin pranuar, duke shpresuar se do të merreshin masa për rritjen e prosperitetit të qytetit dhe rrethinave të tij dhe tashmë ishin fort të zhgënjyer. *“Pabesia e liderëve revolucionarë, mendjelehtësia dhe paaftësia që ato po shfaqin në sjelljen e tyre në qeveri, janë përdorur për ngacmimin e ndjenjave fetare”*, thuhej në raportin e Eyres.⁵⁷

Përfaqësuesit myslimanë të kabinetit, varësia e tij nga vullneti i “Klikës” dhe elementët myslimanë reaksionarë të jugut, konceptoheshin nga të krishterët, si arsye për përkeqësimin e qëndrueshëm të situatës që po vazhdonte në qeverisjen e vendit.⁵⁸ Ndërsa, diferencat fetare po bëheshin më akute, kishte pak shpresë se ato do të harroheshin përkohësisht ndërsa po shpërthente një konflikt me Jugun. Arrestimet e shumta dhe konfiskimet që bëri qeveria revolucionare në krahinën e

⁵⁵ *Po aty.*

⁵⁶ *Po aty*, fl. 897-901. Telegram i Eyres për MacDonald, 2 shtator 1924.

⁵⁷ *Po aty.*

⁵⁸ *Po aty.*

Shkodrës u dukën si tradhti ndaj kontributit të saj, duke sjellë fuqizimin e kundërshtarëve të qeverisë.⁵⁹

Duke dëshmuar mungesë të theksuar përvoje dhe kapaciteti qeverisës, pikërisht në këtë situatë kritike, dy krerët kryesorë të regjimit Fan Noli dhe Luigj Gurakuqi u nisën për të marrë pjesë në punimet e Lidhjes së Kombeve, si delegatë të Shqipërisë. Eyres duke nënvizuar faktin se, ata po largoheshin në një moment kritik, njoftonte se disa njerëz pohonin hapur, se ata nuk kishin ndërmend të kthehen më në Shqipëri. Gjithashtu, ai mendonte se “nuk ishte e pamundur, që mungesa e tyre të ishte një rast për një *coup d’etat* nga ana e ‘Klikës’ dhe partisë ushtarake.”⁶⁰ Qëndrimi i Nolit në Lidhjen e Kombeve, jo vetëm që e largoi atë nga problemet e brendshme, në një periudhë shumë delikate e kritike, por edhe diskutimi, në këtë forum ndërkombëtar, e diskreditoi edhe më tej figurën e tij.

Kundërshtimi i zgjatur dhe i vendosur për të realizuar zgjedhjet, ishte një diskreditim tjetër, i rëndë, për qeverinë dhe gjithashtu dëshmonte se, sa e papërgjegjshme dhe sa e pasinqertë kishte qenë opozita e viteve 1921-1924, e cila e kishte justifikuar gjithë politikën e saj të ashpër ndaj qeverisë, me këtë argument.

Lidhur me qëndrimin e qeverisë së Nolit dhe të grupeve të ndryshme ndaj zgjedhjeve, me interes janë informacionet që sjell Eyres. Ai përshkruan konfliktin midis Nolit dhe bërthamës së “Klikës”, për çështjen e zgjedhjeve, konflikt i cili, për pak sa nuk përfundoi në një grusht të ri shteti. Siç e kemi theksuar më lart, “Klika” i kërkoi Nolit që, para zgjedhjeve, të pranonte rikonstruktimin e kabinetit ose të jepte dorëheqjen. Qeveria kishte qëllimin për t’i shtyrë zgjedhjet deri në pranverë, ndonëse “Partia Nacional-Demokrate” kërkonte mbajtjen e menjëhershme të tyre. Duke dashur të shtynte zgjedhjet, qeveria po vihej në kundërshtim me pjesën më të madhe të popullit. Por dukej se, në këtë amulli dhe lëmsh kontradiktash të mprehta, ishte krijuar një ekuilibër i forcave kundërshtarë. Eyres pohonte: “Shihet nga larg se ‘Partia Nacional-Demokrate’ nuk është dhe aq e fortë sa duket dhe se ka frikë të provojë forcën me qeverinë. Fuqia e qeverisë nuk ka të bëjë me ndonjë virtut të veçantë apo kapacitet dhe sigurisht me asnjë rekord arritjeje

⁵⁹ *Po aty*.

⁶⁰ TNA, FO 371/9644, fl. 1446. Telegram i Parr për MacDonald, 19 gusht 1924.

patriotike, por vetëm, me apatinë dhe mungesën e shpresës së popullit në përgjithësi.”⁶¹

Edhe pas shpalljes së zgjedhjeve, Eyres raportonte përsëri dëshirën e qeverisë së Nolit për t’i shtyrë ato. Ai shkruante: “ Ky dekret u nënshkrua nga Sotir Peci, i cili u kthye para një ose dy muajsh, duke rifilluar detyrën e tij, e cila deri në atë kohë ishte në duart e Fan Nolit. Por, meqenëse, koha për të cilën Sotir Peci ka qenë caktuar, si regjent përfundon para fundit të këtij muaji dhe peshkopi është fuqimisht kundër idesë së zgjedhjeve të dyta, mendohet se ai do të marrë përsëri funksionet e Këshillit të Lartë, ku Sotir Peci është i vetmi anëtar në Shqipëri dhe do të anulojë dekretin e fundit, duke siguruar një datë tjetër të largët, për zgjedhje direkte.”⁶²

E dekurajuar nga destabilizimi i vendit, i cili kishte arritur kulmin me kryengritjen e qershorit, Ministria e Jashtme britanike bënte një vlerësim shumë negativ të procesit të shtetformimit në Shqipëri. Në dokumentin e saj thuhej: “*Shqipëria, që nga rilindja e saj më 1919, nuk ka bërë përpjekje serioze për t’u përballur me vështirësitë e saj të brendshme dhe ka dhënë pak prova të dëshirës serioze për të kontrolluar korrupsionin dhe paraqitjen e një administrate financiare të rregullt.*”⁶³ Londra pohonte se nuk ekzistonte as gatishmëria e qeverisë britanike për të inkurajuar një hua në tregun e Londrës dhe asnjë perspektivë të qeverisë shqiptare për të marrë një hua në rrethanat e tanishme. Lidhur me caktimin e këshilltarit britanik nga Lidhja e Kombeve, FO pohonte se, kjo nuk do ta inkurajonte qeverinë e Madhërisë së tij të lejonte këshilltarin britanik të vepronte në vend.

FO ishte përgatitur edhe për të shkuar më tej në veprimet kundrejt Shqipërisë, duke sugjeruar kontrollin politik dhe administrativ mbi të, ç’ka do të thoshte rivënia në diskutim e statusit të pavarësisë së saj. Në lidhje me këtë, FO pohonte se mendohej gjithashtu, që në një datë të ardhshme, të përcaktohej një skemë me të cilën Shqipëria të vihet nën tutelë ndërkombëtare dhe financat e saj të riorganizoheshin nga një komision ndërkombëtar me fuqi të jashtëzakonshme. Por, sipas saj, populli shqiptar, kishte besim te vetja dhe ishte kryelartë për t’ia lënë të

⁶¹ *Po aty*, FO 371/7330, fl. 943-944. Telegram i Eyres për MacDonald mbi zgjedhjet në Shqipëri, 23 tetor 1924.

⁶² *Po aty*, fl. 952. Telegram i Eyres për zgjedhjet dërguar MacDonald, 16 nëntor 1924.

⁶³ *Po aty*, fl. 880-882. Situata shqiptare, 28 gusht 1924.

huajve financat e tij. “Për sa kohë Shqipëria e ndjen veten fëmija i Europës dhe gjithmonë mund të sigurojë mbrojtjen e interesave të saj nga Fuqitë e Mëdha, politikanët shqiptarë, do të vazhdojnë të refuzojnë faktin e vështirësisë në të cilën ndodhet vendi i tyre.”⁶⁴

Si përfundim, mund të themi se, institucionet që krijoi qeveria e Nolit dhe politika e saj, ishin krijuar në mënyrë joligjore dhe të dhunshme. Ato nuk arritën të siguronin stabilitetin aq shumë të nevojshëm në vend. Kjo e paragjykoi shumë qeverinë e Nolit në arenën ndërkombëtare, duke u gjendur para një izolimi të plotë. Eksperimenti i dhimbshëm i qershorit 1924 pati pasoja të rënda për pozitën ndërkombëtare të Shqipërisë.

Bllokimi i afirmimit ndërkombëtar të shtetit shqiptar dhe izolimi i Nolit, ishte së pari, rezultat i shkatërrimit të institucioneve kombëtare, i ndërprerjes së procesit evolutiv paqësor të zhvillimit të vendit dhe i shkatërrimit të procesit të stabilitetit, nga vetë ai dhe aleatët e tij opozitarë, që erdhën në pushtet me kryengritjen e qershorit. Pas vendosjes së regjimit të tij autoritar, ai nuk ishte në gjendje as ta legalizonte atë qoftë edhe në një formë autoritariste, pasi për zgjedhje të lira e të rregullta as që mund të bëhej fjalë në atë kohë, për arsye të dëbimit me dhunë nga grushti i shtetit të shumicës qeverisëse të vendit.

Ajo që kërkonin Fuqitë e Mëdha në Shqipëri, veçanërisht Britania e Madhe, ishte stabiliteti. Gradualisht u pranua se Noli nuk mund ta siguronte një gjë të tillë. Në këtë mënyrë, lufta që kishte bërë Noli për tre vjet kundër stabilitetit të vendit, po kthehej kundër tij. Ai jo vetëm që kishte dëmtuar interesat themelore të vendit të tij, por e kishte afirmuar veten si një politikan pa asnjë kredibilitet, të rrezikshëm edhe për stabilitetin e rajonit. Kjo çoi në izolimin e tij ndërkombëtar. Krejt ndryshe do të vepronte Zogu. Njohjen ndërkombëtare, të cilën Noli nuk e arriti, Zogu e siguroi me shpejtësi sepse më 15 janar ai mblodhi përkohësisht Asamblenë e shpërndarë, e cila vendosi Vrionin përsëri kryeministër, duke i dhënë kështu ardhjes së tij në pushtet, një bazë të ligjshme.

Dhjetori i vitit 1924, shënoi mbylljen e një periudhe të kaosit politik, e cila kishte shënuar njëkohësisht edhe kulmin e jetës politike shqiptare dhe ishte padyshim periudha më demokratike në historinë politike midis dy Luftërave Botërore në Shqipëri. Por, si rezultat i betejave të brendshme politike, përpjekjet aq të nevojshme për modernizim u lanë mënjanë, ndërsa ato për ndërtimin e shtetit munguan dukshëm.

⁶⁴ *Po aty.*

S u m m a r y

FAN NOLI'S GOVERNMENT IN THE OPTICS OF BRITISH DIPLOMACY

As a conclusion, we can say that the institutions that were created from Noli's government and his policies were created in an illegal and violent way. They couldn't secure the stability so much needed. This, prejudged so much Noli's government in international arenas and being faced before a complete isolation. The painful experiment of June 1924 had grave consequences for international positions of Albania. Blocking of international affirmation of Albanian state and Noli's isolation, was first result of the destruction of national institutions, interruption of evolutive peace process for progress and the destroy of stability process from him and his opposition allies that come in govern with the June revolt. After establishing the authoritarian regime he wasn't able to legalize it, even in an authoritarian way, because there weren't possible to have elections that period of time because of robbery with violence most of the members of the government of the state from *coup of state*.

Stability was most wanted from Great Powers, especially from Great Britain. Gradually was accepted that Noli couldn't reach it. In this way the struggle that Noli made for three years against the stability of the country, was coming back against him. He even damaged fundamental interests of his country and had affirmed himself as a politician without trust, dangerous for stability of international region. This led to his isolation.

December of 1924, scored the end of the political chaos that at the same time noted the peak point of Albanian political life that was obviously most democratic period of time in political historic between two war worlds in Albania. But as result of inner political struggles, most wanted efforts for modernization were left behind and the efforts for building the state were visible missing.